



Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri


Broshurë Informuese

31

**Pyetje dhe
Përgjigje**

**mbi Ligjin Nr.
64/2025 "Për**

**Barazinë
Gjinore"**



1. Çfarë është Ligji nr. 64/2025 për Barazinë Gjinore?

Është ligji që garanton, mbron dhe promovon arritjen e barazisë gjinore si vlerë themelore e zhvillimit demokratik të shoqërisë shqiptare në të gjitha fushat e jetës, publike dhe private.

2. Çfarë synon ky ligj?

Ligji synon të garantojë të drejtën e çdo individi për barazi gjinore dhe mbrojtje efektive nga diskriminimi dhe pabarazitë gjinore, duke promovuar mundësi dhe pjesëmarrje të barabartë në shoqëri.

3. Kujt i drejtohet ligji?

Ligji i drejtohet të gjithë personave që jetojnë ose qëndrojnë në Shqipëri, pa dallim gjinie.

4. Çfarë kupton ligji me "barazi gjinore"?

Barazi gjinore do të thotë të drejta, përgjegjësi, mundësi dhe përfaqësim i barabartë për gratë dhe burrat në të gjitha fushat e jetës.

5. Si e përkufizon ligji gjininë?

"Gjini" nënkupton rolet e ndërtuara në kontekstin social, sjelljet, aktivitetet dhe atributet që një shoqëri e caktuar i konsideron të përshtatshme për gratë dhe burrat.

6. Çfarë është diskriminimi për shkak të gjinisë?

Është çdo trajtim i padrejtë ose i pabarabartë ndaj një personi për shkak të gjinisë, që pengon ose kufizon gëzimin e të drejtave dhe lirive themelore në mënyrë të barabartë.

7. A ndalon ligji diskriminimin ndaj personave LGBTQI+?

Po. Ligji ndalon diskriminimin për shkak të orientimit seksual, identitetit gjinor, shprehjes së identitetit gjinor dhe karakteristikave të seksit.

8. Çfarë është diskriminimi i tërthortë?

Kur një rregull apo praktikë duket neutrale, por në realitet dëmton më shumë një gjini sesa tjetrën.

9. Çfarë është diskriminimi ndërsektorial?

Është diskriminimi që ndodh kur gjinia kombinohet me faktorë të tjerë si aftësia e kufizuar, mosha, etnia apo statusi social. Për shembull: Një vajzë rome me aftësi të kufizuara aplikon për punë, por refuzohet jo vetëm sepse është grua, por edhe për shkak të përkatësisë etnike dhe aftësisë së kufizuar. Në këtë rast, diskriminimi nuk ndodh vetëm për një arsye të vetme, por nga kombinimi i disa faktorëve: gjinia, etnia, aftësia e kufizuar.

10. Çfarë konsiderohet ngacmim ose shqetësim seksual?

Çdo formë e padëshiruar sjelljeje, e shprehur me gjeste, veprime, fjalë, të thëna ose të shkruara, përfshirë komunikimet elektronike, si dhe veprime fizike apo simbolike me natyrë seksuale, që ka për qëllim ose sjell si pasojë cenimin e dinjitetit personal, në mënyrë të veçantë kur krijon një mjedis kërcënues, armiqësor, poshtërues, nënshtrues, përçmues apo fyes.

11. A përfshihet dhuna digjitale në këtë ligj?

Po. Ligji njih si dhunë edhe ngacmimet dhe abuzimet online, përfshirë rrjetet sociale, email-et dhe mesazhet elektronike.

12. Çfarë janë stereotipet gjinore?

Janë ide të paragjykuara që u caktojnë grave dhe burrave role të kufizuara vetëm për shkak të gjinisë së tyre.

13. Çfarë është seksizmi?

Çdo sjellje, gjuhë apo praktikë që nënvlerëson ose diskriminon një person për shkak të gjinisë.

14. Çfarë do të thotë "gjuhë me ndjeshmëri gjinore"?

Është përdorimi i një gjuhe që shmang stereotipet gjinore dhe respekton të gjitha gjinitë në mënyrë të barabartë.

15. A duhet institucionet të përdorin gjuhë me ndjeshmëri gjinore?

Po. Ligji detyron institucionet publike dhe private ta përdorin atë në dokumente, politika dhe komunikim publik.

16. Çfarë janë masat e përgjithshme për sigurimin e barazisë gjinore?

Masat e ndërmarra nga subjektet publike, sipas kompetencave të tyre, për arritjen e barazisë gjinore dhe eliminimin e diskriminimit për shkak të gjinisë apo pabarazive gjinore. Për shembull, miratimi i legjislacionit të përshtatshëm dhe sigurimi i zbatimit të tij.

17. Çfarë janë masat e përkohshme për sigurimin e barazisë gjinore?

Janë masa që përfshijnë kuotat për të arritur përfaqësim gjinor të barabartë e gjithëpërfshirës në çdo fushë, ku personat e njërës gjini nuk gëzojnë pozitë të barabartë, si p.sh. kuotat gjinore që përdoren për të arritur përfaqësim më të barabartë të grave dhe burrave në politikë dhe vendimmarrje.

18. A konsiderohen diskriminim kuotat gjinore?

Jo. Ligji i konsideron masa të nevojshme për të përshpejtuar barazinë faktike gjinore.

19. Çfarë janë masat e veçanta?

Janë masa mbrojtëse për grupe të caktuara, si gratë shtatzëna, nënat e reja apo personat që kujdesen për familjarë me aftësi të kufizuara. Këto masa nuk konsiderohen diskriminim.

20. Çfarë është gjuha e ndjeshme gjinore gjithëpërfshirëse?

Gjuha e ndjeshme gjinore gjithëpërfshirëse shmang stereotipet dhe diskriminimin gjinor, duke përdorur komunikim që respekton dhe përfshin të gjitha gjinitë.

21. Çfarë është buxhetimi i përgjigjshëm gjinor?

Është mënyra se si shteti planifikon dhe përdor buxhetin duke marrë parasysh nevojat e ndryshme të grave dhe burrave.

22. Çfarë është vlerësimi i ndikimit gjinor?

Është analiza që bëhet për të parë si ndikojnë ligjet dhe politikat tek gratë dhe burrat.

23. Pse janë të rëndësishme të dhënat gjinore?

Sepse ndihmojnë institucionet të kuptojnë pabarazitë dhe të hartojnë politika më të drejta dhe efektive në funksion të barazisë gjinore.

24. Kush është institucioni kryesor përgjegjës për zbatimin e ligjit?

Ministria përgjegjëse për çështjet e barazisë gjinore. Aktualisht, institucioni përgjegjës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale.

25. Çfarë është Këshilli Kombëtar i Barazisë Gjinore?

Është organ këshillimor që ndihmon në hartimin dhe monitorimin e politikave për barazinë gjinore.

26. A kanë rol organizatat e shoqërisë civile?

Po. Organizatat jofitimprurëse përfshihen në konsultime, monitorim dhe promovim të barazisë gjinore.

27. Çfarë detyrimesh kanë mediat?

Mediat duhet të përdorin gjuhë me ndjeshmëri gjinore dhe të shmangin stereotipet diskriminuese.

28. Çfarë roli kanë të rinjtë në arritjen e barazisë gjinore?

Të rinjtë kanë rol të rëndësishëm në sfidimin e stereotipeve gjinore, promovimin e respektit dhe ndërtimin e marrëdhënieve të barabarta dhe pa diskriminim.

29. Si mund të raportojë një person diskriminimin gjinor?

Personi mund të ankohet pranë institucioneve publike, Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Avokatit të Popullit ose gjykatës.

30. Kush duhet ta zbatojë këtë ligj?

Institucionet publike, pushteti vendor, bizneset, mediat, organizatat dhe çdo subjekt privat.

31. Pse është i rëndësishëm ky ligj për shoqërinë shqiptare?

Sepse promovon një shoqëri më të drejtë, më gjithëpërfshirëse dhe me mundësi të barabarta për të gjithë.

Barazia gjinore është përgjegjësi e përbashkët!

Një shoqëri e drejtë ndërtohet kur gratë dhe burrat gëzojnë të drejta, mundësi dhe respekt të barabartë.

Kjo broshurë informuese është prodhuar nga Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri.

Autor: © Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri, Maj 2026

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara për subjektin autor. Asnjë pjesë e këtij botimi nuk mund të riprodhohet pa lejen dhe citimin e tij.

Qendra për Drejtësi Gjinore në Shqipëri

Adresa: Rr. Nikolla Tupe, P. 2/4, Ap. 15, Tiranë, Shqipëri

email: genderjusticealbania@gmail.com

website: www.gjalbania.org